



APK

AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR THE PREVENTION OF CORRUPTION




PËR KOSOVËN PA KORRUPTION



Funded by
the European Union





PËRMBAJTJA:

Pavarësia dhe roli i Drejtorit	03
Mandati	04
Parandalimi i Konfliktit të Interesit	05
Deklarimi i pasurisë	07
Deklarimi i dhuratave	11
Mbrojtja e sinjalizuesve	12

PAVARËSIA DHE ROLI I DREJTORIT

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit është një Agjenci e pavarur, e cila i raporton Kuvendit të Kosovës dhe zyrtarët e saj janë të mandatuar që t'i kryejnë detyrat e tyre pa ndonjë presion të jashtëm.

Drejtori i Agjencisë menaxhon buxhetin dhe punën e Agjencisë në tete fusha kryesore, duke përfshirë:



**Deklarimin e pasurisë
dhe dhuratave**



**Parandalimi i
konfliktit të interesit**



**Mbrojtja e
sinjalizuesve**



**Planet e
integritetit institucional**



**Politika strategjike
dhe monitorim**



**Vlerësimi antikorrupsion
i akteve ligjore**



**Raportimi dhe
statistikat**



Administrata

Drejtori gjithashtu mbikëqyr stafin, nxjerr vendime dhe përfaqëson Agjencinë në të gjitha kontaktet e jashtme.

MANDATI

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka mandat zbatimin e disa ligjeve kyçe për parandalimin e korrupsionit, duke përfshirë:

- **Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit,**
- **Ligjin për deklarimin e pasurisë, i cili gjithashtu rregullon pranimin e dhuratave nga zyrtarët, dhe**
- **Ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve.**

Në përputhje me ligjet, Agjencia:



- ▶ **Punon për parandalimin e rasteve të konfliktit të interesit duke dhënë opinione dhe kryen hetime administrative për rastet e pretenduara të konfliktit të interesit,**



- ▶ **Kryen hetime administrative dhe përpunon raportet që merr nga sinjalizuesit e jashtëm, dhe**



- ▶ **Ushtron kontroll të plotë mbi deklaratat e pasurisë nga zyrtarët dhe vërteton saktësinë e tyre dhe gjurmon marrjen e dhuratave nga zyrtarët.**

Për më tepër, Agjencia shqipton gjoba ndaj zyrtarëve të cilët nuk respektojnë detyrimin e tyre për të deklaruar me kohë pasurinë ose dorëzon kallëzime penale në prokurori për deklarata të rreme.

Duke përmbushur mandatin e saj, Agjencia gjithashtu:



- ▶ **Rishikon ligjet për të siguruar që ato përfshijnë të gjitha masat e nevojshme mbrojtëse kundër korrupsionit**



- ▶ **Monitoron zbatimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Korrupsionit**



- ▶ **Ndihmon institucionet publike në hartimin dhe monitorimin e zbatimit të planeve të tyre të integritetit**



- ▶ **Vlerëson rrezikun e korrupsionit në sektorë të ndjeshëm sikurse prokurimi publik, rekrutimi dhe përdorimi i burimeve publike**



- ▶ **Ngrit ndërgjegjësimin e publikut**

PARANDALIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT



Konflikti i interesit është një situatë në të cilën një zyrtar publik ka një interes privat, i cili ndikon në paanshmërinë e tij ose të saj dhe kryerjen objektive të detyrave zyrtare.

Për shembull, një konflikt interesi ndodh kur një zyrtar i lartë publik:



▶ **Është gjithashtu menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i bordit të ndërmarrjes private**



▶ **Është anëtar i më shumë se një organi drejtues të një ndërmarrje publike, institucioni publik, ose shoqëri aksionare të bashkuar në pronësi publike**



▶ **Ofron trajtim favorizues ose informacion konfidencial gjatë kontraktimit të shërbimeve për përfitime personale**



▶ **Ndikon në vendimarrjen e organeve legjislativë, gjyqësore ose ekzekutive për përfitime personale**



▶ **Punësohet ose ofron shërbime në një institucion që ai/ajo e ka mbikëqyrur në më pak se dy vjet që nga largimi i tij/saj, ose drejtpërdrejt ose tërthorazi nëpërmjet një të afërmi ose të besuari**

Agjencia si dhe publiku kanë një rol për të luajtur në parandalimin e konfliktit të interesit.

Ndërsa Agjencia këshillon zyrtarët dhe institucionet se si të shmangin konfliktin e interesit dhe si të trajtojnë raste të tilla nëse ndodhin, ajo gjithashtu ka të drejtë të monitorojë çdo prokurim publik ose proces rekrutimi dhe të iniciojë hetime administrative për çdo rast të mundshëm të konfliktit të interesit.

Publiku, nga ana tjetër, gjithashtu mund të raportojë çdo konflikt të mundshëm interesi, qoftë drejtpërdrejt tek institucioni, duke kontaktuar zyrtarin e caktuar për parandalimin e konfliktit të interesit, ose në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

Pasi Agjencia kryen një hetim administrativ për një rast të mundshëm të konfliktit të interesit, ajo mund:



Të kërkon nga institucioni i punësimimit për nisjen e procedurës për shkarkimin e një zyrtari

Të kërkojë nga një institucion të rishikojë, revokojë ose anulojë një akt juridik të nxjerrë si rezultat i një konflikti të interesit



Të iniciojë procedurë kundërvajtëse në gjykatë në rast të shkeljes së ligjit, ose të paraqesë kallëzim penal në prokurori në rast të veprës penale



Gjykata mund të shqiptojë gjobë dhe të ndalojë ushtrimin e funksioneve publike nga 6 muaj deri në 2 vjet.

DEKLARIMI I PASURISË

Deklarimi i pasurisë është një mjet thelbësor në parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit dhe në forcimin e integritetit të institucioneve publike.

Siç është paraparë me Ligjin për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurive dhe Dhuratave, disa kategori të **zyrtarëve të lartë** duke përfshirë edhe Presidentin; Deputetët e Kuvendit; Ministrat dhe Zëvendës Ministrat; Gjyqtarët dhe Prokurorët; Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës; Kryesuesit, Anëtarët e Bordeve dhe Drejtorët e Përgjithshëm të ndër marrjeve publike, Kryetarët dhe Nënkryetarët e Komunave

dhe **zyrtarët publikë** si Mjekët, Profesorët e universiteteve publike, zyrtarët e prokurimit publik, doganierët, inspektorët tatimorë, hetuesit policorë, janë të detyruar të deklarojnë pasurinë.



Ata janë të detyruar ta bëjnë këtë:



Në këtë mënyrë pasuria e tyre bëhet gjithashtu
çështje e shqyrtimit publik.

Deklarimi i pasurisë, e cila mund të deklarohet në internet, ndër të tjera, duhet të përfshijë informacion për:



- ▶ **Të ardhurat vjetore duke përfshirë pagën, mëditjet, tarifat nga organet drejtuese dhe komisionet, dhe nga të drejtat e pronësisë intelektuale**



- ▶ **Pronësinë ose veprimtarinë dhe fitimin e fituar nëpërmjet një shoqërie private, edhe nga anëtarët e ngushtë të familjes**



- ▶ **Kursime, para të gatshme, valutë digjitale dhe depozita, në Kosovë dhe jashtë saj, edhe të anëtarëve të ngushtë të familjes**



- ▶ **Vlera e pasurisë së paluajtshme, pasurive të luajtshme, stoqet dhe letrat me vlerë**



- ▶ **Huatë, borxhet dhe detyrimet**



- ▶ **Shpenzimet, donacionet dhe transaksionet mbi 3000 euro**

Ndërsa Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit:



- ▶ **Kontrollon nëse deklaratimet e pasurisë janë të plota dhe të sakta**



- ▶ **Kryen kontroll të plotë të deklaratimeve të pasurisë dhe verifikon të dhënat në Kosovë dhe jashtë saj**



- ▶ **Sanksionon zyrtarët që nuk respektojnë afatet e përcaktuara ose nuk e deklarojnë plotësisht pasurinë**



- ▶ **Paraqesin kallëzim penal në Prokurori**



Ju gjithashtu mund të kontrolloni deklarinim e pasurisë nga të gjithë zyrtarët dhe të raportoni deklarinim e mundshëm të rremë të pasurisë në Agjenci!

Zyrtarët të cilët nuk arrijnë të deklarojnë në mënyrë të rregullt pasurinë e tyre do t'i nënshtrohen gjobave të mëposhtme:



1

Nëse zyrtari i lartë ose zyrtari publik e dorëzon deklarin e pasurisë me vonesë deri në 15 ditë, do të paguajë gjobë deri në 500 euro

Nëse një zyrtar i lartë ose zyrtari publik e dorëzon deklarin e pasurisë me vonesë prej më shumë se 15 ditësh ose deklaron në mënyrë të rreme pasurinë e tij/saj, Agjencia do t'ia referojë çështjen Prokurorisë dhe Gjykata mund ta dënojë zyrtarin me burgim deri në pesë vjet, ndërsa çdo pasuri e pa raportuar do të konfiskohet



Gjithashtu, Gjykata do të shqiptojë një dënim shtesë me ndalim të ushtrimit të funksionit publik nga 1 deri në 10 vjet pas vuajtjes së dënimit me burgim dhe, nëse është e aplikueshme, Gjykata mund të ndalojë të drejtën për t'u zgjedhur në post publik për 1 deri në 4 vjet.

DEKLARIMI I DHURATAVE

Krahas deklaramit të pasurisë, zyrtarët publikë në të gjitha nivelet janë të detyruar të regjistrojnë të gjitha dhuratat që marrin pranë institucioneve përkatëse dhe ka kufizime në vlerën e dhuratave që mund të pranojnë.

Si rregull, zyrtarët publikë nuk duhet të kërkojnë kurrë një dhuratë!

Për më tepër, një zyrtar publik:



- ▶ **Nuk pranon dhurata ose favore që lidhen me kryerjen e detyrave të tyre, me përjashtim të dhuratave të marra sipas protokollit, të cilat kalojnë në pronësi të institucionit**



- ▶ **Mund të pranojë një dhuratë të rastit me vlerë deri në 50 euro vetëm një herë në vit nga i njëjti person ose institucion, ndërsa vlera totale e një dhurate të rastit të marrë nga një zyrtar gjatë një viti nuk mund të kalojë 250 euro**

Çdo institucion duhet të ketë një **regjistër të dhuratave** që përmban informacion për të gjitha dhuratat e marra nga zyrtarët e tyre, vlerën e tyre dhe emrat e personave ose institucioneve që i kanë dhënë dhuratat.

Në përputhje me Ligjin për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurive dhe Dhuratave, Agjencia gjithashtu ka të drejtë:



- ▶ **kontrollon dhe auditon regjistrin e dhuratave dhe në rast të parregullsive kërkon që institucionet të marrin masa për zbatimin e ligjit**



- ▶ **Ka të drejtë për të vendosur për pranimin ose jo të një dhurate me kërkesë të zyrtarit**



- ▶ **Shqipton gjoba në rastet e shkeljes së ligjit**

MBROJTJA E SINJALIZUESVE

Sinjalizuesi - është çdo person i cili raporton ose shpalos informacione për një kërcënim ose cenim të interesit publik në kontekstin e marrëdhënies së vet të punës në sektorin publik ose privat.

Përderisa raportimet e tilla mund të bëhen drejtpërdrejt në institucionin ku ka ndodhur incidenti, sinjalizuesit mund t'i drejtohen edhe Agjencisë, me ç'rast konsiderohen si **sinjalizues të jashtëm**.

Agjencia është përgjegjëse për shqyrtimin dhe procedimin e rasteve të **sinjalizimit të jashtëm** përmes hetimit administrativ kur ato:



- ▶ Lidhen me punëdhënësin e sinjalizuesit



- ▶ Kanë karakter urgjent që shoqërohet me rrezik serioz dhe të menjëhershëm ose dëm të pakthyeshëm



- ▶ Ekziston dyshimi i arsyeshëm se mund të ndërmerren veprime të dëmshme ndaj sinjalizuesit ose provat mund të fshihen ose shkatërrohen nëse do të kryhej denoncim i brendshëm



- ▶ Sinjalizuesi ka dyshim të arsyeshëm se procedurat e brendshme të sinjalizimit nuk janë efektive

Agjencia mund të paraqesë kallëzim penal në Prokurori në rast të elementeve të veprës penale ose të kërkojë nga Gjykata që të fillojë procedurë kundërvajtëse nëse institucionet publike (Inspektorati i Punës në rastin e institucioneve private) kryejnë parregullsitë e mëposhtme:




- ▶ **Nuk emëron zyrtarin përgjegjës për procedurat e sinjalizimit dhe të njoftojë me shkrim të gjithë punonjësit për të drejtat e tyre për të filluar procedurën e sinjalizimit**



- ▶ **Nuk mbron sinjalizuesin nga çdo veprim i dëmshëm**



- ▶ **Nuk ndërmerr veprime pas raportimit të rastit brenda afateve ligjore**



- ▶ **Nuk i njofton sinjalizuesit për rezultatin e procedurës brenda afatit të caktuar, ose për ecurinë dhe veprimet e ndërmarra në procedurë me kërkesën e tij/saj**



- ▶ **Nuk i jep qasje sinjalizuesit në dosjet e lëndës dhe të drejtën për të marrë pjesë në veprimet e ndërmarra gjatë procedurës së sinjalizimit**

dhe në rastet kur pengojnë sinjalizimin me çdo veprim që synon parandalimin e raportimit ose zbulimit të shkeljes së interesit publik, ose cenon konfidencialitetin e procedurave.

PËR KOSOVËN PA KORRUPSION





APK

AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR THE PREVENTION OF CORRUPTION



0800 10 800



info@akk-ks.org



www.akk-ks.org

Kjo broshurë është financuar nga Bashkimi Evropian.
Përmbajtja e saj është përgjegjësi vetëm e Agjencisë për Parandalimin
e Korrupsionit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet
e Bashkimit Evropian.